



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Tiranë, më 10 / 10 / 2022

Nr. 5362 / Prot.

URDHËR

Nr. 545 datë 10 / 10 / 2022

**PËR
PEZULLIMIN NGA DETYRA TË NOTERIT KELTI MANO, PËR GJITHË
PERIUDHËN E KOHËZGJATJES DERI SA TË SHPREHET GJYKATA ME VENDIM
TË FORMËS SË PRERË SI PERSON I DYSHUAR PËR VEPRËN PENALE
“FALSIFIKIMI I DOKUMENTAVE” PARASHIKUAR NGA NENI 186/3 I
KODIT PENAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 18 dhe 56 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Shtetasi Kelti Mano rezulton i licensuar nga Ministria e Drejtësisë për ushtrimin e veprimtarisë noteriale në Korçë, me Licensë nr. 257, datë 13.06.2012.

Referuar informacioneve paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me shkresë nr. 141 prot., datë 14.06.2022, protokolluar pranë nesh me nr. 2437/4 prot., datë 17.06.2022 dhe Gjykata e Apelit Korçë me shkresë nr. 607 prot., datë 14.06.2022, protokolluar pranë nesh me nr. 2437/3 prot., datë 17.06.2022, rezulton se ndaj noterit Kelti Kostaq Mano është vendosur masa e sigurimit personal me karakter ndalues “*Pezullimi i ushtrimit të një detyrë me karakter publik*” parashikuar nga nenit 240/1/a e 242 të K.Pr. Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumentave*” parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, duke i ndaluar plotësisht veprimtarinë që lidhet me detyrën e noterit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. 113, datë 22.04.2022 ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë duke caktuar ndaj shtetasit Kelti kostaq Mano masën e sigurimit personal me karakter ndalues “*Pezullimi i ushtrimit të një detyrë me karakter publik*” parashikuar nga nenit 240/1/a e 242 të K.Pr. Penale, si person i dyshuar për

kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, duke i ndaluar plotësisht veprimtarinë që lidhet me detyrën e noterit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. 174 prot., datë 06.05.2022 ka vendosur vazhdimin e masës e sigurimit personal me karakter ndalues, caktuar me vendimin nr. 113, datë 22.04.2022 "Pezullimi i ushtrimit të një detyrë me karakter publik" parashikuar nga neni 240/1/a e 242 të K.Pr. Penale, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, duke i ndaluar plotësisht veprimtarinë që lidhet me detyrën e noterit.

Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 88, datë 31.05.2022 ka vendosur miratimin e vendimit nr. 113 prot., datë 22.04.2022 dhe vendimit nr. 174 prot., datë 06.05.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, për noterin Kelti Kostaq Mano.

Sa më lart, në kushtet ku vepra penale për të cilën noteri Kelti Mano është i dyshuar, lidhet direkt me veprimtarinë noteriale e cila ka karakter publik si dhe në zbatim të vendimeve si më lartë përmendur, vlerësohet pezullimi i Licencës së noterit Kelti Mano deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga gjykata mbi veprën penale për të cilën është marrë i pandehur.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 18 dhe 56 e vijues, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" si dhe Vendimit nr. 88, datë 31.05.2022 nga Gjykata e Apelit Korçë e cila ka vendosur miratimin e vendimit nr. 113 prot., datë 22.04.2022 dhe vendimit nr. 174 prot., datë 06.05.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, për noterin Kelti Kostaq Mano,


URDHËROJ:

1. Pezullimin nga detyra të Noterit Kelti Kostaq Mano, Noter i Dhomës Kombëtare të Noterisë Korçë, për gjithë periudhën e kohëzgjatjes deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga gjykata mbi veprën penale për të cilën është marrë i pandehur.
2. Administrimin e vulave respektive në sektorin arkiv-protokoll pranë Ministrisë së Drejtësisë, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të Noterit Kelti Mano, deri në përfundim të afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhëri.
3. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Degën Vendore të Noterisë Korçë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.
5. Regjistrimin e këtij Urdhri në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.
7. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja

